REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E GJILANIT
Nr./Br./No: 170
12
Data/Datum/Tarih: 22.09.2023
GJILAN - GNJILANE - GILAN

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
MUNICIPAL GJILAN - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYESI

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK
DEPARTMENT OF ECONOMY DEVELOPMENT – UPRAVA ZA EKONOMSKI RAZVOJ

# Thirrje publike

Për subvencionim të pjesëmarrjes në panairin e Agrobiznesit "AGROKOS"

Panairet tregtare janë platforma të shkëlqyera për të krijuar rrjetëzim me profesionistë të tjerë të industrisë, klientë të mundshëm dhe bashkëpunëtorë. Ky panair është i dizajnuar në atë mënyrë që ju ndihmon të krijoni kontakte të vlefshme që ju çojnë në partneritete, bashkëpunime dhe mundësi shitjeje në të ardhmen.

Komuna e Gjilanit, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik fton bizneset nga sektori i Agrobizneseve, Prodhues dhe Përpunues të Ushqimit, Pijeve dhe Gastronomisë të marrin pjesë në panairin "AGROKOS" i cili do të mbahet me 19 dhe 20 Tetor 2023 në sallën 1 Tetori në Prishtinë.

Komuna e Gjilanit do të subvencionojë pjesëmarrjen e pesë (5) mikro-bizneseve të komunes së Gjilanit në këtë panair.

Bizneset e vogla prodhuese, të cilat janë të interesuara nga Komuna e Gjilanit për pjesëmarrje në këtë panair duhet të parashtrojnë kërkesë DZHE-së dhe të njejtën t'a dorëzojnë në Qendrën për Shërbim me Qytetarë jo më vonë se deri më datë **29 Shtator 2023.**

Drejtor i Zhvillimit Ekonomik

Enver Shabani